



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

BASHKIA PATOS  
KËSHILLI I BASHKISË  
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1862 /  
4 Prot.

Patos, më 12/12/2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 11 DHJETOR 2024

Vendi: "Salla e Këshillit Bashkiak Patos"

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjesë publike me temë: "Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor 2025-2027".

**Baza Ligjore:** Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKM Nr. 460, datë 29.6.2022 "Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit, 2021–2027".

**Pjesëmarrës:** Zv/kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Rafaela Xeba, Drejtor i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Golloshi, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, *rreth 23 pjesëmarrës (administratorë të njësive administrative, përfaqësues të shoqërisë civile, kryetarë të fshatrave, përfaqësues të prefekturës, grupe interesit etj)*

## **Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj**

**Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj**- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik, sot jemi mbledhur në këtë dëgjesë publike për të bërë prezantimin e materialit të Planit Lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027, për të cilën do të kemi një prezantim edhe nga ana e ekzekutivit. Ju ftoj të dëgjojmë së bashku materialin e përgatitur nga ana e ekzekutivit dhe më pas mund të kalojmë në pyetje dhe diskutime sipas rregullave përkatëse të konsultimeve publike.



**Kryetar i Këshillit  
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”**

**Dhjetor 2024**

**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos znj. Ina Sauli-** përshëndetje! Unë ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe uroj që kjo dëgjesë të jetë një bashkëbisedim dhe të shtroni të gjitha pyetjet që ju keni në lidhje me prezantimin që do të bëj ekzekutivi.



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos  
znj. Ina Sauli**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”**

**Dhjetor 2024**

**Drejtor i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Golloshi**- përshëndetje! Faleminderit të gjithëve, falenderoj stafin që ka përgatitur materialin e strategjisë. Ne jemi në fazën që kemi përgatitur



**Drejtor i Zhvillimit Bujqësor  
z. Orges Golloshi**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”**

**Dhjetor 2024**

nje draft dhe do ta paraqesim këtu, por është shumë e nevojshme për ne që ju të jepni edhe sugjerimet tuaja në mënyrë që ne ti përfshijmë në këtë dokument përpara miratimit në Këshillin Bashkiak. Qëllimi i këtij plani është të formoj një sektor bujqësor të qendrueshëm dhe të mbështhes jetën ekonomike apo të përmirësoj jetën e fermerëve. Bujqësia në bashkinë Patos hyn te sektorët më të rëndësishëm dhe parcelat e ndodhura në territorin e bashkisë Patos janë të favorshme për shumë kultura bujqësore si ullishte, vreshta, frutore etj. Në sektorin e bujqësisë sipas të dhënave janë të punësuar më shumë se 1/3 e bashkisë Patos. Aktivitetet kryesore në bashkinë Patos janë kultivimi i bimëve në ara, kultivimi i serave dhe i drurëve frutore. Blegtoria është një nga degët më të rëndësishme të prodhimit të fermave privatë në bashkinë Patos. Gjithashtu një aktivitet tjeter kryesor është edhe bletaria që ka shumë të ardhura dhe po rritet ndjeshëm në të gjithë territorin. Një numër i madh blegtorësh kanë përfituar nga skemat e AZHBR-së nga skemat e vitit 2024. Për sa i përket sistemit të ujitjes dhe kullimit në bashkinë Patos duhet të kuptojmë që ky sistem është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë. Bashkia Patos ka në pronësi kanale të dytrë dhe të tretë kullues në një gjatësi totale 164 km, ndërsa sistemi ujitës i transferuar përfshin rezervuarin e Zharrëzës, elektropompa Belinë dhe një sistem total kanalesh prej 126 km, Rritja e aftësive ku ne duhet të fokusohemi në rritjen e aftësive ujitëse pasi është një pikë kyçë. Bazuar në verifikimet e bëra në terren vetëm 900 ha ujiten nga të tre skemat që përfshin territorin e bashkisë Patos, pavarësisht se sip. Totale e parashikuar për ujitje është 2475 ha. Problematikat kryesore të nxjerra janë mungesa e azhormnimit në disa fshatra apo problematika e rregjistrimit fillestare dhe në disa zona ka sjell pengesë për fermerët mos pasja e një certifikate pronësie duke i përjashtuar nga mundësia e përfitimit te skemës së fermerëve. Mungesa e burimeve ujore, mungesa e kullimit në disa parcella mbetet shqetësim dhe është e pamunduar nga ana jonë ndërhyrja në rehabilitimin e tyre. Problem tjetër janë edhe të dhënat

e bonitetit dhe të dhënat që prej vitit 2003 nuk kemi më të dhëna. Një tjetër punë operative që ne punojmë vazhdimisht është gjendja jo e mirë e rrugëve bujqësore. Objektivat e zhvillimit bujqësor janë mbështetur në politikat e zhvillimit rural të bazuar në ligjin e zhvillimit rural. Ato synojnë rritjen e të ardhurave të zhvillimit rural duke përmirësuar kushtet e punës, rritjen e prodhimit, stabilitet të tregut duke garantuar qëndrueshmëri në prodhimin bujqësor, cilësi dhe siguri ushqimore duke garantuar që zinxhiri ushqimor të ketë një cilësi të qendrueshmë dhe të mos shkaktojë pasoja të dëmshme në shëndetin e njerëzve. Gjithashtu synon uljen e varfërisë duke gjetur mënyra që gjenerojnë punësim. Kemi edhe disa objektiva kryesor siç janë përmirësimi i parcelave me gabime ku nuk përputhet fakti në hartën kadastrale. Sipas ligjit "Për Kadastrën" 111/2018 mund të bëhet një marrëveshje për të zgjidhur problematikat. Investimet në infrastrukturë janë një objektiv shumë i rëndësishëm për ne pasi kanë të bëjnë me rehabilitimin e rrugëve kryesore. Gjatë vitit 2024 ne kemi ndërhyrë me hapjen e rrugëve parcelare dhe<sup>3</sup> kryesisht është prekur zona kodrinore pasi nuk kanë pasur asnjë rrugë për të kaluar në ullishte. Kjo mbetet një sfidë për ne dhe do të vazhdojmë edhe më vonë. Krijimi i skemave të ujitjes me puse krahas skemave të tjera janë edhe dy ministacione në territorin e bashkisë të cilat mbulojnë një sipërfaqe të papërfshirë më parë dhe të paprekur nga sistemi i ujitjes. Gjithashtu po planifikohet për t'u mbuluar i gjithë fshati Belinë me një ministacion tjetër. Mirëmbajtja e sistemit të vazhdueshëm të ujitjes dhe kullimit është një punë e vazhdueshme nga ana jonë, ku ndërhyr herë pas here në pastrimin e kanaleve vaditës dhe kullues. Gjithashtu objektiv është mbështetja financiare me anë të granteve nga ana e bashkisë ku ne jemi në vitin e tretë radhazi duke patur parasysh edhe barazinë gjinore si dhe mbështetje për GVV ITEA Patos, për të cilën është zhvilluar edhe dëgjësë publike, qëllimi i të cilit është ndikimi në zonat rurale duke sjell sa më shumë projekte. Objktivi 4 ka të bëjë me nxitjen në bashkëpunim me fermerët në mënyrë që të nxiten për të aplikuar në skemat që mundur asistimi i fermerëve me gjithë informacionet e nevojshme. Krijimi i kadastrës së ullirit është një projekt ambicioz që do bëjë të munduar reklamimin e prodhimit vendas. Menaxhimi i riskut trë përhapjes së zjarreve në tokën bujqësore është një clement shumë i rëndësishëm pasi edhe me sektorin e emergjencave jemi në bashkëpunim të vazhdueshmë për ruajtjen e tokave nga këto rreziqe. Përdorimi i energjisë së rinovueshme përfurnizimin me energji të stacioneve të pompimit të ujit përujite, nxitja e përdorimit të paneleve diellor dhe sigurimi i të ardhurave të qendrueshme përfumerët dhe ngritja e një pike grumbullimi përmbetjet e fermerëve dhe ndërtimi i një tregu bujqësor dhe blegtorial, nxitja e fermerëve përm

përmirësimin e produktivitetit në punë janë disa objektiva të tjerë të rëndësishëm të këtij dokumenti.

Ky ishtë një draft dokument dhe ne mirëpresim çdo sugjerim pasi siç e thash komentet dhe sugjerimet tuaja na ndihmojnë të reflektojmë dhe përmirësojmë dokumentin. Faleminderit!

**Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj-** Faleminderit Orges për prezantimin e materialit! Kush ka pyetje dhe sugjerime është i latur t'i paraqesi në këtë dëgjesë publike.



**Kryetar i Këshillit  
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor**

**2025-2027”**

**Dhjetor 2024**

**Përgjegjës i Emergjencave Civile z. Arben Shpërdheja-** Në planin e paraqitur nga bujqësia është bërë një punë shumë e mirë, por aty u panë konstatime dhe objektiva. E kam fjalën për zonat e pa azhornuara, tokat që janë pa dokument. Marr një rast shembull kur emri i personit është në formularin 6, por nuk është lëshuar AMTP. Është thënë që do të shkojnë listat para disa kohësh në qarkë apo prefekturë dhe nuk i është kthyer përgjigjë institucionit. Çfarë është bërë me këto dosje dhe ku ka ngelur puna për të marrë një dokument që këto toka të certifikohen dhe naga ana tjetër të paguhet dhe taksa pranë institucionit. Pra kush e lëshon dokumentin? Prefektura, ASHK apo bashkia?



**Përgjegjës i Emergjencave Civile  
z. Arben Shpërdheja**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor**

**2025-2027”**

**Dhjetor 2024**

**Kryetar i fshatit Zharrëz z. Abedin Hoxha-** Unë dëgjova që u përmend rezervuari i Zharrëzës. Si do ndërhyjnë aty kur ai nuk punon dhe po bën mbi 5 vjet që nuk funksionon?




**Kryetar i fshatit Zharrëz  
z. Abedin Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”**

**Dhjetor 2024**

**Kryetar i org. Familja e Dëshmorëve z. Novruz Toska** - Krahas me këto që dëgjuam shumë të detajuara, unë kam një pyetje për grupin e punës. A do vadisin fermerët e Zharrëzës këtë vjet? Kush është eficencia e granteve që jep qeveria për ujitjen dhe kullimin? Sa janë përdorur këto grante dhe çfarë aksesi kanë? Fondet duhen përdorur për kanalet vaditëse dhe janë disa që nuk pastrohen dhe ju keni fuqi punëtore. A pastrojnë këta, a punojnë mjetet për pastrim? Ju jeni institucioni kryesor që duhet të kërkonit burimin e ujit.



**Kryetar i org. Familja e Dëshmorëve  
z. Novruz Toska**

**Dëgjesë publike me temë:**

**“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”**

**Dhjetor 2024**

**Drejtor i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Golloshi-** lidhur me shqetësimin e Arbenit për pjesën e certifikimit e kemi konstatuar dhe kjo është shumë e drejtë pasi pengohen fermerët, por këto probleme janë dërguar në ASHK, dosjet e Grizës janë plotësuar dhe ndodhen në atë institucion. Deri tani nuk kemi përgjigje për këto dosje, por ky është një problem të cilin ne do të vazhdojmë ta ndjekim dhe do të mundohemi të gjemë një mënyrë komunikimi dhe bashkëpunimi. Kjo përbën edhe problem për aplikimin në skema. Dosjet e tokave i vlerëson komisioni vlerësues që ndjek edhe procedurën për certifikim.



Drejtor i Zhvillimit Bujqësor  
z. Orges Golloshi

Dëgjesë publike me temë:  
“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”

Dhjetor 2024

Për rezervuarin e Zharrëzës, problematikat janë bërë të njoitura dhe të ditura dhe mundësia vaditëse e tij po shteron dhe po humbet kapacitetin. Nga ana e emergjencave civile janë hapur disa thirrje dhe një nga këto është edhe mirëmbajtja e digave ku pjesë e projektit do të jetë edhe mirëmbajtja dhe dalja e eficencës se plotë për kontrollin e vaditjes dhe ne shpresojmë që këtë ndërhyrje për aq kapacitet sa ka rezervuari t'i japi zgjidhje pjesës në Zharrëz. Për pjesën e eficencës po e nis përgjigjën nga Belina ku me stacionin atje përllogaritet të vaditen rrëth vaziqës po mendohet që t'ëndohet edhe një ministacion si në Sheqishte. Pjesa tjetër mbulohet nga skema e Kurjanit që vitin që kaloi ka qenë në kushte kritike, prandaj në vazhdimësi po mendohet të bëhet një zgjidhje alternative me një skemë që po përllogaritet. Gjithashtu do mendohet hedhja me pompim nga lumi Seman për të mbuluar pjesën me vaditje të fshatrave Verbas dhe Zharrëz. Kjo është zgjidhje alternative e menduar nga bashkia Patos. Rezervuari i Kurjanit është i menaxhuar nga tre bashki dhe ne e kemi shfrytëzuar në maksimum. Lidhur me transfertën nga qeveria, për ujitjen dhe kullimin fondet e transfertës shkojnë për mbulimin e stafit që menaxhon ujitjen dhe punën operacionale që zhvillohen si mirëmbajtja e kanaleve kulluese.

**Përfaqësues i prefekturës së qarkut Fier z. Agim Gjondedaj** - problemi i dosjeve të tokave nuk ka më lidhje me prefekturën. Të gjitha dosjet janë dërguar institucionit përkatës ASHK dhe prefektura nuk disponon më dokumentacion.



Përfaqësues i prefekturës së qarkut  
Fier  
z. Agim Gjondedaj

Dëgjesë publike me temë:  
“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”

Dhjetor 2024

**Kryetar i fshatit të Ri z. Bexhet Rredhi-** Çfarë mbështetje do të ketë për fermerët që dëmtohen nga ana e bashkisë? Sepse ne nuk na ka thirrur njeri. Madje është edhe një grup në Zharrëz që u prek nga stuhia, nuk na ka thërritur njeri.



**Kryetar i fshatit të Ri  
z. Bexhet Rredhi**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”  
Dhjetor 2024**

**Drejtor i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Golloshi-** Nga ana e bashkisë praktika që përfshihet edhe në tregullore është që dëmtimet nga fatkeqësitet natyrore është që ngrihet një grup pune, vlerësohet gjendja dhe paraqitet në këshillin bashkiak për përashtim nga taksa bujqësore në masën 70%. Nga ana jonë ne kaq kemi mundësi, por ne mund ta referojmë rastin edhe më tej për ndonjë mbështetje nga qeveria. Kemi pasur bashkëpunim, por nuk ka një VKM të veçantë.



**Drejtor i Zhvillimit Bujqësor  
z. Orges Golloshi**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”  
Dhjetor 2024**

**Përfaqësues i prefekturës së qarkut Fier z. Agim Gjondedaj** - a keni ju një database për të gjithë fermerët që janë të përfshirë në përsitimin e skemës kombëtare të fermerëve ? Cila është përqindja e përsituesve. Për sa i përket atyre fermerëve që përashtohen sepse ende nuk është bërë certifikimi i pronave kjo është një problematik e shtrir në kohë, por ky problem duhet të zgjidhet me një bashkëpunim midis ASHK dhe ju direkt. Unë doja të dija lidhur me këtë se cila është përqindja e përsituesve të fermërëve nga skema?



Përfaqësues i prefekturës së qarkut

Fier

z. Agim Gjondedaj

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor

2025-2027”

Dhjetor 2024

**Drejtore i Zhvillimit Bujqësor z. Orges Golloshi**- sigurisht që ne kemi një rregjistër fermeri dhe në asnjë moment nuk i shkëpusim kontaktet me ta. Në rakordimet që bën sektori i bujqësisë në drejtorinë qendrore Lushnje, marrim të dhëna për bashkinë Patos dhe kjo ndodh zakonisht në priudhën e fundvitit siç jemi edhe tani. Vjet në vitin 2023, kemi pasur 780 fermerë me numër NIPT. Këtë vit besoj do kemi një numër edhe më të madh. Masa e përfitimit është në skemën e naftës. Pjesa tjeter ka qenë për fara, fidan dhe blektori për numrin e gjethëve dhe bashkia jonë ka qenë përfituese në mase të madhe çdo vit. Fermerët janë asistuar nga bashkia gjatë gjithë kohës.



Drejtore i Zhvillimit Bujqësor

z. Orges Golloshi

Dëgjesë publike me temë:

“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor

2025-2027”

Dhjetor 2024

**Përfaqësues i prefekturës së qarkut Fier z. Agim Gjondedaj**- unë shikoj që problematikat këtu lidhen me bërjen më eficiente të rezervarve. Unë besoj pa qenë ekspertë që rezervuarët janë baza kryesore për zhvillimin bujqësor të gjithë zonës dhe për rritjen e cilësisë së produkteve. Mënyra më e mirë është që këto burime ekzistuese të rimenaxhohen, të rikonstruktohen dhe të janë eficent gjithmonë në rastet kur duhen përvaditje. Edhe problemi i azhornimit është një problem i madh që pengon fermerët. Unë do të doja që bashkia të krijonte një trajktore direkte me ASHK për të zgjifhur çështjen e pronësisë.

**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos znj. Ina Sauli-** tashmë është ngritur një marrëveshje me ASHK, e cila është në fazën e nënshkrimit dhe në fazën e ngritjes së grupit të punës. Së shpejti do të arrijmë të kemi një zgjdhje për këtë problem.



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos  
znj. Ina Sauli**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”**

**Dhjetor 2024**

**Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj-** besoj se i ezauruam të gjitha pyetjet dhe sugjerimet. Nëse nuk keni diçka tjeter e quajmë të mbylluar këtë dëgjesë publike. Faleminderit edhe njëherë për pjesëmarrjen.



**Kryetar i Këshillit  
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:  
“Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor  
2025-2027”**

**Dhjetor 2024**

**Koordinator i Konsultimit Publik**

Simela Shahinaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Simela Shahinaj".

**Sekretar i Këshillit**

Refaela Xeba

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Refaela Xeba".

